VENDIM
Nr.28, datë 12.5.2006

PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË PRODHUAR NË HEC VITHKUQ, NGA SHOQËRIA FAVINA SHPK DHE FAVINA 1 SHPK

Në mbështetje të neneve 9; 8 pika 2, germa b, 26 dhe 28, të ligjit nr.9072 datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të vendimeve të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 27.5.2005 "Për dhënien e licencës për prodhimin e energjisë elektrike për shoqërinë Favina sh.p.k. për centralin e Vithkuqit", nr.85, datë 27.12.2005 "Për transferimin e licencës nga shoqëria Favina sh.p.k., te Favina 1 sh.p.k." nr.7, datë 16.2.2006 "Për fillimin e procedurave të shqyrtimit", si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.60, datë 29.12.2004 "Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël", Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.5.2006, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga Favina 1 sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për 3-mujorin e IV të vitit 2005 dhe viti 2006, në HEC Vithkuq, nga shoqëria Favina sh.p.k. dhe Favina 1 sh.p.k.

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për periudhën 1.10.2005-31.12.2005, prodhuar në HEC Vithkuq, nga shoqëria Favina sh.p.k., transferuar shoqërisë Favina 1 sh.p.k. të jetë 5.3 lekë/kWh.
2. Çmini i shitjes së energjisë elektrike për periudhën 1.1.2006-31.12.2006, prodhuar nga shoqëria Favina 1 sh.p.k., për H/C Vithkuq, të jetë 5 lekë/kWh.
3. Ngarkohet shoqëria "Favina 1" sh.p.k. dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Pjetër Dema